



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 9.1 Ligjit për Eficiencë të Energjisë nr.04/L-016, në pajtim me Ligjin për Energji nr. 05/L-181, dhe nenin 56 shkronja b) të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, si dhe në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të Komunës së Podujevës dhe GIZ-it GmbH për krijimin e Sistemit të Menagjimit të Energjisë në nivel Lokal nr.prot.02-016/01-0070516/17, dt. 13.09.2017, merr:

VENDIM PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

Neni 1

Për hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë për Komunën e Podujevës, formohet grupi punues, në përbërje:

1. Rasim Fejza – kryesues, *Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim*
2. Avni Sylja – anëtar, *Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim*
3. Ramadan Zymeri – anëtar, *Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim*
4. Rizah Muçolli – anëtar, *Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit*
5. Ismet Kadriu – anëtar, *Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit*
6. Florie Mani – anëtar, *Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit*
7. Veton Aliu – anëtar, *Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit*
8. Fatmir Latifi – anëtar, *Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit*
9. Labinot Kajtazi – anëtar, *Drejtoria e Administratës*
10. Halit Vërshefci – anëtar, *Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*
11. Ardian Emmini – anëtar, *Drejtoria e Arsimit*
12. Sabit Sylja – anëtar, *Drejtoria për Buxhet e Financa*
13. Agim Idrizi – anëtar, *Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e grupit punues:

-Mbështetë dhe ndihmon përgatitjen e Hartimit të Planit të Veprimit për Eficiencë të Energjisë, ofrimin e të gjitha të dhënave për Asociacionin Kosovar për Energji të Ripërtitëshme dhe Eficiencë të Energjisë (AKEREE), të cilat nevojiten në përgatitjen e Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë dhe përgatitjen e projekteve tri vjeçare të cilat do të implementohen me masa eficiente.

-Krijon bazën për mbledhjen e të dhënave mbi konsumin e energjisë në mënyrë periodike, shpenzimeve të energjisë dhe të dhënave të tjera relevante nga tereni së bashku me ekipet e GIZ-it, duke mbajtur një regjistër që bën të mundur selektimin e treguesve të potencialit të eficiencës së energjisë për sektorët e objekteve komunale që konsumojnë energji.

-Monitoron ecurinë e hartimit të planit, masave për Eficiencë të Energjisë, vlerëson performancën e llogaritur të kursimit të energjisë dhe reduktimin e kostos, duke identifikuar devijimet e mundshme nga plani dhe propozon veprime korigjuese në rast nevoje, (duke përfshirë afatet e zbatimit, vlerësimin e buxhetit, kursimet e pritshme të energjisë, si dhe burimet e financimit të projekteve).

-Kryen të gjitha procedurat tjera deri në miratimin e PKVEE-së, në Kuvendin e Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

Nr.02-020/04-0030701/18
Podujevë, 12 prill 2018

 **Kryetari i Komunës**
Agim Veliu